

# **Raport Monitorimi i realizimit të zbatimit të Planit të Integritetit 2023**

**Bashkia Shijak**

## Përmbajtja

<b>I. Hyrje</b> .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>I. Monitorimi i PI për bashkinë Shijak Viti 2023.</b> .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>I.1 Qasja Vlerësuese</b> .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>I.2 Metodologjia e vlerësimit.</b> .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>I.3 Mbledhja dhe analiza e të dhënave</b> .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>II. Gjetjet e Raportit</b> .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>III. Konkluzione dhe Rekomandime</b> .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

## Lista e Figurave

Figura 1: Statusi i Zbatimit të Masave .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Figura 3: Statusi i Zbatimit të Masave, Objektivi I.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Figura 4: Statusi i Zbatimit të Masave, Objektivi II .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Figura 5: Statusi i Zbatimit të Masave, Objektivi III.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

## Hyrje

Integriteti institucional dhe lufta kundër korrupsionit konsiderohen si një nga prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare. Në kontekstin e sektorit publik, integriteti konsiston në përmbushjen e detyrimeve të transparencës, llogaridhënies, etikës, ndershmërisë, efektivitetit dhe efikasitetit në kryerjen e detyrave dhe të ushtrimit të funksioneve rregullatore dhe administrative.

Miratimi dhe monitorimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore është jetësuar nëpërmjet koordinimit dhe zbatimit të nismave anti-korrupsion të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK) 2015-2023. Ndërkohë menaxhimi i riskut të integritetit për NJVV-të, si proces në vetëvete rrjeth nga objektivi specifik (objektivi A11) i SNKK dhe Planit të Veprimit (2018-2023), miratuar me VKM nr.516, datë 1.7.2020, si dhe qëllimit politik 5 të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-20230 (SNDQV) - objektivi specifik 5.2: “Nxitja e politikave kundër korrupsionit në nivel vendor dhe konsolidimi i mëtejshëm i arritjeve mbi integritetin”, miratuar me VKM nr.252, datë 21.04.2023”. Ky proces vjen në linjë edhe me rekomandimet e Komisionit Evropian (2018) për Shqipërinë në kuadër të integritetit në Bashkimin Evropian, ku një nga rekomandimet e dhëna është zbatimi i dokumentit të Strategjisë Kundër Korrupsionit, duke iu referuar konkretisht mungesës së një sistemi funksional të menaxhimit të integritetit në institucionet publike në vend.

Procesi i menaxhimit të riskut të integritetit në nivel vendor, ka një qasje gjithëpërfshirëse ku angazhohen të gjitha strukturat e brendshme të bashkisë. Ndërsa hapi i parë i tij lidhet me hartimin e Planit të Integritetit për njësinë vendore (detajuar ky i fundit edhe me një Plan Veprimi 3-vjeçar), monitorimi dhe raportimi i planit të integritetit është etapa tjetër e menaxhimit të riskut në bashki. Monitorimi është periodik (çdo vit) dhe përfshin kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve dhe drejtuesve të bashkisë, për zbatimin e masave të miratuara për trajtimin e risqeve, në përputhje me përgjegjësitë që ata kanë. Ndërkaq raportimi është një procedurë e rregullt që siguron zbatimin e Planit të Veprimit për risqet e integritetit, sipas afateve kohore të parashikuara.

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) në kuadër të funksioneve të saj për realizimin e objektivave të Qeverisë Shqiptare për garantimin e qeverisjes së mirë, ka vijuar me procesin e monitorimit të zbatimit të planeve të integritetit në nivel bashkie për vitin 2023. Raporti i monitorimit është hartuar në përputhje me metodologjinë e monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore. Analiza e të dhënave dhe vlerësimi i progresit të zbatimit të Planit të Veprimit të Planit të Integritetit për këtë periudhë raportimi është bërë në zbatim të Urdhrit nr. 553, datë 30.09.2021 “*Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore*”.

.

## **Raporti i Monitorimit të PI për bashkinë Shijak Viti 2023.**

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të NJVV për vitin 2023 është i dyti dokument monitorimi, i hartuar në përputhje me Metodologjinë e Monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, të miratuar me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.553, datë 30.09.2021.

Në Planin e Integritetit të bashkisë Shijak janë përcaktuar gjithsej 5 objektiva për të cilat janë parashikuar fushat me risk dhe masat dhe aktivitete për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** Përmirësimi i procesit të menaxhimit të riskut të integritetit në fushën e menaxhimit të pronave dhe planifikimit të territorit.
- **Objektivi II** Përmirësimi i procesit të menaxhimit të riskut të integritetit në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit
- **Objektivi III** Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspektet e veçanta të etikës dhe integritetit.
- **Objektivi VI** Përforcimi i integritetit institucional të bashkisë, përmes menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore si dhe forcimit të shërbimeve publike dhe mbështetëse.
- **Objektivi V** Forcimi i llogaridhënies publike dhe transparencës së bashkisë, për rritjen e besimit dhe përfshirjes së qytetarëve ndaj veprimtarisë së bashkisë.


Për bashkinë Shijak Plani i Integritetit është konceptuar i shtrirë në një periudhë 3-vjeçare dhe konkretisht 2022-2025.

**Situata e monitorimit të Planit të Integritetit Bashkia Shijak për periudhën janar - dhjetor 2023** rezulton si më poshtë:

Nga monitorimi i procesit në bashkinë Shijak rezulton se në totalin prej 44 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2023 janë **zbatuar** 28 masa/aktivitete ose ne 63 %, **në proces zbatimi** 11 masa/aktivitete ose 25 % dhe **të pazbatuara** 5 masa/aktivitete ose 12 %.

Bashkia Shijak	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2023	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të perealizuara
Realizimi ne total i objektivave të PI		44	28	11	5

## STATUSI I ZBATIMIT TË MASAVE



Gjatë vitit 2023, Bashkia Shijak ka hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike për aspekte të veçanta të integritetit, përsa i përket fushës së menaxhimit të pronave, procedurat e prokurimeve,, është rishikuar gjithashtu rregullorja e brendshme e bashkisë në të cilën janë përfshirë rregulla për ruajtjen e informacionit konfidencial dhe të dhënave personale, janë realizuar trajnime për anëtarët e kabinetit lidhur me Kodin e Sjelljes/Rregulloren për etikën dhe integritetin në bashki. Hartimi i formateve për kërkesat për leje nga punonjësit e bashkisë për ushtrimin veprimtarive të dyta si mesimdhënie e të tjera, Krijimi i një regjistri të deklarimit të dhuratave për punonjësit e bashkisë.

### Qasja Vlerësuese

Raporti i monitorimit të zbatimit të planit të integritetit të bashkisë, përmban një analizë të përgjithshme të zbatueshmërisë dhe progresit të vitit 2023 për aktivitete dhe masat të kuadrit rregullator të performancës institucionale, menaxhimit të burimeve njerëzore si dhe riskut në fusha të veçanta të përgjegjësisë për ti rezistuar shkeljeve të integritetit si dhe çështjeve të ndryshme të organizimit dhe funksionimit të strukturave teknike të bashkisë.

### Metodologjia e vlerësimit.

Ky raport është hartuar në bazë të kontributit të dhënë nga drejtoritë dhe strukturat teknike të bashkisë Shijak bazuar në aktivitetet dhe masat e parashikuara për zbatim për vitin 2023 në planin e veprimit Planit të Integritetit dhe ecuria e deritanishme e tyre.

## Mbledhja dhe analiza e të dhënave.

Të dhënat e këtij raporti janë grumbulluar nga Koordinatori i Integritetit të bashkisë Shijak në përmbushje të rolit të tij si struktura e posaçme përgjegjëse për mbledhjen dhe analizën e informacionit mbi ecurinë e raportit të monitorimit.

## Gjetjet e Raportit

**Objektivi I** “Përmirësimi i procesit të menaxhimit të riskut të integritetit në fushën e menaxhimit të pronave dhe planifikimit të territorit”


Ky objektivi, synon menaxhimin e riskut të integritetit me fokus në fushat e menaxhimit të pronave të bashkisë dhe planifikimit të territorit. Një menaxhim më i mirë i këtyre të fundit do të forconte ekonomikisht bashkinë dhe do të lejonte shfrytëzim më të mirë të pronave bashkiake nga subjektet ekonomike, të inventarizimit dhe hipotekimit të pronave, miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, etj

Ky objektivi për vitin 2023 përmban 9 masa/aktivitete specifike të planifikuara për tu zbatuar nga njësitë e përfshira, të cilat i referohen kuadrit rregullator të brendshëm të integritetit në fushën e administrimit të pronave, inventarizimit si dhe administrimit dhe zhvillimit të territorit..

Gjatë periudhës raportuese nga 9 masa/aktivitete për tu realizuar janë në proces realizimi 7 masa/aktivitete ose 77% dhe nuk janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 23% sipas tabelës dhe grafikut, si më poshtë:

Objektivi I	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2023	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të porealizuara
Përmirësimi i procesit të menaxhimit të riskut të integritetit në fushën e menaxhimit të pronave dhe planifikimit të territorit		9	0	7	2

## REALIZIMI I MASAVE DHE AKTIVITETEVE



Për këtë periudhë monitorimi Janar Dhjetor 2023 bashkia është në vijimësi të zbatimit të masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Vlerësimi të nevojës së riorganizimit të brendshëm të një sektori të bashkisë, duke i shtuar dhe funksionin e administrimit dhe menaxhimit të pronave, me burime njerëzore të mjaftueshme dhe teknike në fushë.
- Vlerësimin i ndjekjes procedurale të procesit për dhënien e lejeve të ushtrimit të transportit nga sektori i shërbimeve dhe infrastrukturës publike, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit.
- Vlerësimi i ndjekjes procedurale të procesit për dhënien e lejeve të ushtrimit të transportit nga sektori i shërbimeve dhe infrastrukturës publike, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit
- Lidhja e një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërmjet Bashkisë dhe Hipotekës me fokus mbështetjen institucionale për hipotekimin e objekteve të reja të rindërtimit.
- Lidhja e një Marrëveshje bashkëpunimi me ASHK-në për prioritetizimin e hipotekimit të objekteve të reja nga rindërtimi.
- Të miratohet draft-plani i përgjithshëm vendor


**Objektivi II** “Përmirësimi i procesit të menaxhimit të riskut të integritetit në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit”.

Përmes këtij objektivi synohet synon përforcimin e procesit të menaxhimit të riskut në fushën e menaxhimit financiar dhe atë të kontrollit. Menaxhimi i mirë i financave vendore përmes përmirësimit të efikasitetit të proceseve financiare dhe kontrollit më të mirë të tyre, do të siguronte më shumë të ardhura për bashkinë, duke rritur kështu potencialin ekonomik të saj.

Gjatë periudhës raportuese lidhur me këtë objektiv janë planifikuar për tu realizuar 4 masa/aktivitete nga të cilat 2 janë realizuar ose 50% dhe 2 janë në proces realizimi ose 50% sipas tabelës dhe grafikut si më poshtë:

Objektivi II	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara per vitin 2023	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht tërealizuara	Masa dhe aktivitete te parealizuara
Përmirësimi i procesit të menaxhimit të riskut të integritetit në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit”.		4	2	2	0

#### REALIZIMI I MASAVE DHE AKTIVITETEVE



Për këtë periudhë monitorimi Janar Dhjetor 2023 janë realizuar masat dhe aktivitete si më poshtë vijon:

- Bashkia ka vlerësuar nevojën për caktimin e një punonjësi si mbikëqyrës për procedurat e prokurimeve publike në bashki.
- Raporti i vlerësimit t'i komunikohet titullarit të bashkisë sipas procedurave të zbatimit gjatë prokurimeve.


**Objektivi III** “Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspektet e veçanta të etikës dhe integritetit”

Ky objektivi synon të forcojë mekanizmat që lidhen me garantimin e integritetit në aspekte të veçanta të etikës, për të krijuar një kuadër rregullator efektiv që përmban dispozita të nevojshme që janë të lidhura me çështjet e integritetit.

Gjatë periudhës raportuese për vitin 2023 janë planifikuar për tu realizuar 6 masat/aktivitete nga të cilat janë realizuar 5 masa/aktivitete ose 83% dhe nuk është realizuar 1 masë/aktivitete ose 17%, sipas tabelës dhe grafikut si më poshtë:

Objektivi III	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2023	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të përealizuara
Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspektet e veçanta të etikës dhe integritetit”		6	5	1	0

## REALIZIMI I MASAVE DHE AKTIVITETEVE



Për këtë periudhë raportimi nga realizimi i masave dhe aktiviteteve janë arritur rezultate në këto drejtime:

- Parashikimi në Rregulloren e Brendshme i rregullave për ruajtjen e informacionit konfidencial dhe të dhënave personale në nivel bashkie.
- Realizimi i trajnimeve të kabinetit të kryetarit të bashkisë në lidhje me Kodin e Sjelljes/Rregulloren për etikën dhe integritetin në bashki.
- Krijimi i një regjistri të deklarimit të dhuratave për punonjësit e bashkisë.
- Hartimi i formateve për kërkesat për leje nga punonjësit e bashkisë për ushtrimin e veprimtarive të dyta (mësimdhënie, konsulenca etj.)
- Krijimi i një regjistri të deklarimit të dhuratave për punonjësit e bashkisë.

**Objektivi IV** “Përforcimi i integritetit institucional të bashkisë, përmes menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore si dhe forcimit të shërbimeve publike dhe mbështetëse”


Ky objektivi, synon forcimin e procesit të zhvillimit të burimeve njerëzore dhe të shërbimeve publike e mbështetëse në bashki, me qëllim identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit. Përmirësimi i proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse në institucion, do të sigurojë zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive të nevojshme në kuadër të zbatimit

dhe konsolidimit të mekanizmave garantuese të integritetit në institucion, me qëllim rritjen e profesionalizimit të personelit dhe përmirësimin e integritetit të zyrtarëve.

Ky objektivi për vitin 2023 përmban 21 masa/aktivitete specifike të planifikuara për tu zbatuar nga njësitë e përfshira, të cilat i referohen kuadrit rregullator të brendshëm të integritetit në fushën e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse nga të cilat janë realizuar plotësisht 19 masa/aktivitete ose 90% dhe është në proces 1 masë/aktivitet ose 5% dhe nuk është realizuar 1 masë/aktivitete ose 5% sipas grafikut dhe tabelës më poshte.

Objektivi IV	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2023	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të parealizuara
Përforsimi i integritetit institucional të bashkisë, përmes menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore si dhe forcimit të shërbimeve publike dhe mbështetëse		21	19	1	1

#### REALIZIMI I MASAVE DHE AKTIVITETEVE



Për këtë periudhë raportimi nga realizimi i masave dhe aktiviteteve janë arritur rezultate në këto drejtime:

- Realizimi i trajnimeve të inspektorëve të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore për legjislacionin fiskal
- Realizimi i trajnimeve periodike, pjesë e Planit Vjetor të Trajnimeve për punonjësit e bashkisë për ngritjen e kapaciteteve në proceset e prokurimeve publike, veçanërisht në procesin e hartimit të termave të referencës.
- Realizimi i trajnimeve të inspektorëve të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore për legjislacionin fiskal
- Realizimi i trajnimeve periodike për punonjësit e njësisë së prokurimeve publike për legjislacionin në prokurime publike dhe përditësimin e tij.
- Trajnime të brendshme dhe të jashtme, me punonjësit e bashkisë që janë pjesë e ekipeve të menaxhimit të PBA-së për PBA-në (procesi, raportimet etj).
- Të vlerësohen nevojat e institucionit për burime njerëzore të specializuara për pozicione të shërbimit civil, kryesisht në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, Shërbimeve dhe Infrastrukturës Publike si edhe për Sektorin e Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore.
- Trajnime për punonjësit e Bashkisë për legjislacionin mbi etikën dhe integritetin.
- Informimi i punonjësve të bashkisë për Planin Vjetor të Trajnimeve, bazuar në identifikimin e nevojave brenda institucionit (përfshihen trajnimet e ofruara nga ASPA-ja si trajnime të brendshme apo nga aktorë të tretë brenda apo jashtë vendit).

**Objektivi V** “Forcimi i llogaridhënies publike dhe transparencës së bashkisë, për rritjen e besimit dhe përfshirjes së qytetarëve ndaj veprimtarisë së bashkisë”


Ky objektivi, synon forcimin e llogaridhënies publike dhe transparencës në bashki, nëpërmjet përmirësimit të proceseve rregulluese të konsultimeve publike, rritjen e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe zhvillimin e transparencës proaktive. Përmirësimi i këtyre proceseve do të ndikojë në rritjen e besimit të publikut dhe përfshirjen më të madhe të tij në veprimtarinë e bashkisë.

Ky objektivi për vitin 2023 përmban 4 masa/aktivitete specifike të planifikuara për tu zbatuar nga njësitë e përfshira, të cilat i referohen kuadrit rregullator të brendshëm të integritetit në fushën e llogaridhënies publike dhe transparencës së bashkisë ng të cilat janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 50% dhe nyk janë realizuar 2 /masa/aktivitete ose 50% e masave sipas grafikut dhe tabelës si më poshtë:

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat/ aktivitetet sipas tabelës, si më poshtë:

Objektivi V	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara per vitin 2023	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të parealizuara
Forcimi i llogaridhënies publike dhe transparencës së bashkisë, për rritjen e besimit dhe përfshirjes së qytetarëve ndaj veprimtarisë së bashkisë.		4	2	0	2

### REALIZIMI I MASAVE DHE AKTIVITETEVE



Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat/ aktivitetet sipas tabelës, si më poshtë:

- Trajnime për punonjësit e Bashkisë për legjislacionin e informimit dhe kufizimet e tij, përfshirë edhe për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Përfshirja e këtyre trajnimeve në Planin Vjetor të Trajnimeve të Bashkisë

## Gjetje të tjera:

- ✚ Të Vlerësohen dhe ndiqen procedurat e procesit për dhënien e lejeve të ushtrimit të transportit nga sektori i shërbimeve dhe infrastrukturës publike, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit.
- ✚ Të vlerësohen nevojat e riorganizimit të brendshëm të një sektori të bashkisë, duke i shtuar dhe funksionin e administrimit dhe menaxhimit të pronave, me burime njerëzore të mjaftueshme dhe teknike në fushë
- ✚ Hartimi i një plani pune me afatet dhe personat përgjegjës të përcaktuar, për ngarkimin e dokumentacionit elektronik të dosjeve të personelit në sistemin HRMIS
- ✚ Hartimi dhe miratimi i një plani strategjik të bashkisë.
- ✚ Të publikohen kontratat publike sipas dispozitave në fuqi dhe modelit të PT-së për njësitë e qeverisjes vendore.

## Konkluzione dhe Rekomandime

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për vitin 2023, të gjetjeve që ky document na ofron, të dhënave analitike të raportuara dhe të analizës së kryer rezultojnë se:

- Bashkia Shijak ka vijuar me zbatimin e planit të Integritetit duke realizuar një nivel të mirë të realizimit të masave të planifikuara për integritetin (61-80%) në 63% për vitin 2023, për sa i përket realizimit të objektivave ka arritur një nivel të mirë realizimi në objektivin e tretë dhe të katërt.
- ✓ Të vijohet me zbatimin dhe raportimin e masave dhe angazhimeve të evidentuara më sipër që vijojnë të jenë në proces apo janë të porealizuara, sipas fushave të etikës, burimeve njerëzore dhe fushave të veçanta të përgjegjësisë
- ✓ Të fokusohet vëmendja në realizimin e masave/aktiviteteve sipas fushave të ndyshme funksionale në nivel bashkie
- ✓ Dërgimi brenda afateve të përcaktuara si dhe në përputhje me formatet e kërkuara të kontributeve nga strukturat dhe institucionet përgjegjëse
- ✓ Përmirësimi i kapaciteteve në strukturat/institucionet përkatëse për zbatimin dhe raportimin sipas metodologjisë së monitorimit të PI.